




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot:
Dep. <b>2-D/DPK</b>	Prot. No. <b>01-1388/13</b>
Nr. llogj:	Data:
Broj. shënime:	Datum:
Nr. pages: <b>02</b>	Dat: <b>14-05-2013</b>



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **10.04.2013**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. *Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-907/13 për ztr. Kelmend Spahiu – Drejtor i Klinikës Oftamologjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.*

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-907-13, për Zyrtarin e lartë, z. Kelmend Spahiu – Drejtor i Klinikës Oftamologjike në QKUK (Ministria e Shëndetësisë), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-907/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Spahiu së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, ztr. Spahiu është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, për të vazhduar të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z. Spahiu, në Agjenci ka sjellur dokumentin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPK / DPKI – 03 -1333/13) në të cilën shihet se z. Spahiu ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në ndërmarrjen private Poliklinika “Spahiu” në të cilën tashmë nuk ushtron asnjë lloj funksioni menaxhues.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

